



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

Korçë, më 15.06.2022

**VENDIM**

Nr. 07 datë 15/06/2022

**“PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR”**

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 5 të ligjit 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Kryesia, Këshilli i Qarkut Korçë,

**VENDOSI:**

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës të pensionit të posaçëm shtetëror:
  - Koço Vangjel Qëndro, lindur në Senicë më 15.05.1927
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik e shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KESHILLIT TË QARKUT**

**ANA VERUSHI**

Konceptoi: Gjergji Kristo  
Sekretari i Këshillit të Qarkut: Bashkim Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### RELACION

#### Për Përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror

#### Për Z. Koço Qendro

Në datën 31.05.2022, pranë Këshillin e Qarkut Korçë, është paraqitur kërkesa e z. Koço Qëndro për ti propozuar Këshillit të Ministrave caktimin e një shtese pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që i takon nga sigurimet shoqërore.

Nga dokumentacioni që i ka bashkëlidhur kërkesës rrezulton se kërkuesi i përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 429, Date 12.9.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” që Këshilli i Qarkut Korçë ti propozojë Këshillit të Ministrave caktimin e një pensioni të posaçëm shtetëror.

I lindur në Senicë, Sarandë më 15.05.1927, z. Koço Vangjel Qëndro prej gushtit të vitit 1943 e deri në vitin 1954 ka shërbyer si oficer në ushtrinë popullore ku edhe më pas u vendos në qytetin e Korçës. Në Korçë është bërë edhe aktor profesionist me një karrierë tepër të pasur ku në 24 vitet e trupës së estradës janë realizuar 82 premiera ka interpretuar mbi 570 role. Në larminë e premierave e roleve ku ka interpretuar vlen të përmendim dy rolet më të suksesshme, “Ser Enry Eugiçin” në Komedinë “Nata e 12” e William Shekspir dhe “Harpagoni” në komedinë “Kopraci” të Molierit e shfaqur me sukses në vitin 1978, 2003 dhe 2019 me një rekord prej 364 shfaqesh. Në karrierën e Z. Qëndro nuk mund të mos përmendim e rolet në kinematografi ku ndër filmat ku ka interpretuar janë: “Përballimi”, “Vendimi”, “Agimet e stinës së madhe”, “I teti në bronx” dhe “Tre ditë nga një jetë”.

Me plot gojë mund të quhet veterani i skenës korçare me gati 7 dekada që interpreton i palodhur. Gjatë karrierës së tij të gjatë ai është vlerësuar me shumë urdhëra, medalje e tituj, ndër të cilët mund të përmendim:

- “Medaljen e Çlirimit”, Presidiumi i Kuvendit Popullor, Tiranë 09.07.1946
- “Medaljen e Trimërisë”, Presidiumi i Kuvendit Popullor, Tiranë 05.02.1953

- Medaljen e “10 Vjetorit të Ushtrisë”, Presidiumi i Kuvendit Popullor, Tiranë 10.07.1953
- Urdhërin “Ylli i Kuq”, Presidiumi i Kuvendit Popullor Tiranë 21.06.1954
- Fletë lavdërimi si Aktori më i dalluar në Festivalin Kombëtar të Estradave, Tiranë 17-24.12.1968
- Urdhërin “Naim Frashëri” të klasit III, Presidiumi i Kuvendit Popullor , Tiranë 30.06.1975
- Urdhërin “Naim Frashëri” të klasit III, Presidiumi i Kuvendit Popullor , Tiranë 26.01.1980
- Çmimin “Pandi Raidhi” Teatri “A.Z.Çajupi”, Korçë 01.07.2004
- Medalje “Për kontribut të shquar në Çlirimin e Atdheut”, Këshilli i Ministrave, Tiranë 29.11.2004
- Titulli “Personalitet i shquar i qytetit në Art”, Këshilli i Bashkisë Maliq 29.08.2007
- “Nderi i Senicës” nga Shoqata “Besëlidhja e Senicës” 14.08.2010
- Titulli “Emblema e Artë”, Bashkia Korçë dhe Këshilli bashkiak 26.10.2010
- Urdhëri “Naim Frashëri” i Argjendtë, Presidenti i Republikës, Tiranë 09.11.2010
- Titulli “Anëtar Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ”, Korçë 20.07.2012
- Çmimi “Koko Fest” Korçë 2018
- Çmimi “Aktori më i mirë” Koko Fest, Korçë 2019
- Çmimi “Aktori i Vitit” Akademia Kult 2019
- Çmimi i “Karrierës” Në festivalin teatror “Kadri Roshi”, Gjirokastër 21-28.10.2019
- Çmimi “Aktori i Vitit” nga Fondacioni “Harpa”, Fier 22.01.2020
- Çmimi i “Karrierës” në edicionin e 17 të Festivalit Ndërkombëtar të Monodramës, Maliq 30-05.06.2021
- Çertifikatë “Falemderimi dhe Vlerësimi” në edicionin e 17 të Festivalit Ndërkombëtar të Monodramës, Maliq 30-05.06.2021
- Titulli “Mjeshtër i Madh”, Tiranë 20.01.2022

Z. Koço Qëndro i përmbush parashikimet e nenit 5 pika b të ligjit 7703 ”Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesa përmban gjeneralitetet, e kërkesit dhe është e shoqëruar me dokumentat, si vijojnë:

- Fotokopjen e letërnjoftimit elektronik dhe çertifikatën e gjendjes civile;
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për masën e pensionit;
- Kopjet e noterizuara të dokumentave që vërtetojnë meritat e veçanta si titujt, medaljet, urdhërat etj;

Dokumentacioni i paraqitur është konform VKM Nr.429, datë 12.09.2002 ”Per kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT**

**ANA VERUSHI**

Konc. Gj. Kristo


